

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10242, DATË 25.2.2010 “PËR INSTITUTIN E STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZIMIT NË SHQIPËRI”

I. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTAKTIT

Projektligji propozohet për të saktësuar periudhën e rregjimit komunist në Shqipëri në funksion të objektit të ligjit si dhe për të plotësuar kriteret e nevojshme për anëtarët e Bordit dhe punonjësit e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

Objekti dhe qëllimi i ligjit është i lidhur me krimet dhe pasojat e komunizmit në Shqipëri pas çlirimit të vendit dhe jo me të gjithë periudhën që nga krijimi i forcës politike komuniste antifashiste. Dokumentat historikë kanë treguar se Partia Komuniste Shqiptare e themeluar në 8 nëntor 1941 fitoi mbështetje popullore veçanërisht me programin politik dhe me platformën për krijimin e një fronti të gjerë lufte, ku do të merrnin pjesë pa dallim të gjitha forcat politike dhe antifashiste të vendit. Partia Komuniste Shqiptare, në programin e saj të shpallur, nuk shtronte kryerjen e revolucionit socialist, diktaturën e proletariatit dhe as shtetëzimin e mjeteve të prodhimit apo luftën e klasave. Ajo shtronte çështjen e çlirimit të vendit, rivendosjen e pavarësisë kombëtare dhe ndërtimin e një rendi demokratik në Shqipëri. Me luftën Antifashiste Nacional-Çlirimtare u arritën objektivat themelore dhe konkretisht çlirimi i vendit dhe rivendosja e pavarësisë kombëtare.

Rregjimi komunist nuk mund të lidhet me periudhën e luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare (në vijim “LANÇ”), luftë e cila u fitua me gjakun e mijra dëshmorëve dhe siguroi pavarësinë e vendit.

Vetëm pas përfundimit të LANÇ, Fronti Demokratik, ku ishin të përfshirë komunistët mori në dorë qeverisjen e vendit duke vendosur disa detyra, ndërmjet të cilave: eliminimi i kundërshtarëve politikë, qeverisja e re, hartimi i Kushtetutës, reforma ekonomike etj.

Nisur nga parashtrimi i mësipërm periudha e komunizmit, objekt i këtij ligji, nuk mund të jetë periudha para datës 28 nëntor 1944.

Gjithashtu, pjesë e objektit të ligjit është dhe përcaktimi i kriterëve që duhet të plotësojnë punonjësit e institutit. Neni 18 i ligjit përcakton se nëpunësit dhe punonjësit e institutit e të arkivit duhet të jenë persona që gëzojnë besueshmëri.

Për qëllimet e këtij ligji, i besueshëm është çdo person, që përveç kriterëve të përcaktuara në këtë nen, të plotësojë edhe kushtet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

II. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucioni që ngarkohet me zbatimin e këtij projektligji është Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri si dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

III. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji i propozuar nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

DEPUTETËT PROPOZUES:

Alket Hyseini

Spartok Bruno

Alen Xhep

Ediolar Braho

Jorgis Gjylfj

Bashkim Lino

Aurora Moro

Edmond Leke

Ilirije Gjume

Adnan Shumeti